



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/180
Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M
Për Krijimin e Zonës së Lirë Ekonomike

1. Krijohet Zona e Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Prizrenit.
2. Qëllimi i krijimit të zonës ekonomike është tërheqja e investimeve të huaja dhe vendore, përmirësimi i kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ngritjes së standardit të jetesës për atë rajon si dhe krijimi i vendeve të reja të punës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/180
Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Administratës Publike që pas konsultimeve me Komunën e Prishtinës të përgatisin Studimin për Zhvendosjen e Institucioneve kryesore të Qeverisjes në drejtim të zonës së quajtur Prishtina e Re, fshati Hajvali.
2. Pas aprovimit të Studimit nga pika 1. e këtij vendimi të përgatitet projekt-propozimi për zhvendosje i cili do të aprovohet nga Qeveria.
3. Autorizohet Ministria e Financave që në rast nevojë për shpenzimet e këtij misioni të parashikoj buxhet shtesë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/180

Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/180

Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Buxhetet e aprovuara të Kuvendit Komunal të Rahovecit dhe Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit nga këto dy komuna, përcillen në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe me Ligjin nr.04/L-194.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/180
Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221 dhe Ligjin nr. 04/L-116 si dhe Ligjin nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2013.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

për Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/180

Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 43 të Ligjit nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Qendrore "Aeroporti i Gjakovës" Sh. A./AGJ e cila do të ketë në pronësi, të menaxhoj, të operoj dhe të mirëmbajë Aeroportin e Gjakovës.
2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në cilësinë e Kryesueses së Komisionit Ndër-Ministror për Ndërmarrje Publike (NP), autorizohet që të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionare e vetme në "Aeroportin e Gjakovës" Sh. A. dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme të nevojshme dhe të përshtatshme për zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë regjistrimin ligjor dhe inkorporimin e shoqërisë së re aksionare, si dhe transferimin dhe regjistrimin e të gjitha asetëve dhe të drejtave pronësore mbi objektet dhe pajisjet në aeroport në N. P. "Aeroporti i Gjakovës" Sh. A.
3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, së bashku me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë do t'i propozojnë Qeverisë një listë që përmban emrat e 4 (katër) kandidatëve për emërim në Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve të N. P. "Aeroporti i Gjakovës" Sh. A. Gjatë përpilimit të kësaj listë të kandidatëve, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të sigurojnë respektimin e të gjitha kërkesave të nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 04/L-111.
4. Për funksionalizimin e N. P. Aeroporti i Gjakovës dhe zhvillimin e aktiviteteve themelore të përkohshme të mirëmbajtjes, gjatë procesit të rishikimit do ndahen mjete buxhetore në shumën prej 150,000.00 (njëqindpesëdhjetë mijë) euro nga kursimet në buxhetin aktual të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

5. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/180

Datë: 28.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-184 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Energjinë e Republikës së Kosovës për vitet 2013-2022.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës për miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë